Ae.nr.10/17

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Liridon Maloku, kryetar i kolegjit, Mahir Tutuli dhe Qerim Ademaj anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses NH "NN" sh.a. me seli në Gjakovë, të cilën e përfaqësojnë me autorizim Z.D. nga Gjakova, kundër të padituës "NN" sh.a, (ish Gorenje-NN) sh.a me seli në Gjakovë, të cilën e përfaqëson me autorizim A.H., për pagesën e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesat e paditëses dhe të padituës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike III.C.nr.277/15 e datës 07/11/2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **27/05/2019,** mori këtë:

A K T GJ Y K I M

REFUZOHEN si të pa themelta ankesat e paditëses NH "NN" sh.a. me seli në Gjakovë dhe të padituës NN sh.a, (ish Gorenje-NN sh.a) me seli në Gjakovë dhe **VËRTETOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike III.C.nr.277/15 e datës 07/11/2016.

A r s y e t i m

Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktgjykimin ankimor III.C.nr.277/15 e datës 07/11/2016, në pikën I të dispozitivit ka vendosur që të aprovoj pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses NH "NN" sh.a me seli në Gjakovë dhe ka detyruar të padituën NN sh.a (ish-Gorenje NN) sh.a me seli në Gjakovë, t'ia paguaj borxhin, paditëses në shumën e përgjithshme prej 15,000.00 euro, me kamatë ligjore duke filluar nga data e paraqitjes se padisë 03/07/2015, e deri në pagesën definitive të gjitha këto në afat paritiv prej 7 ditëve nga data e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim, ndërsa në pikën II të dispozitivit ka vendosur të refuzon si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses për pjesën tjetër në shumën prej 8,000.00 euro, ndërsa në pikën III të dispozitivit ka vendosur që secila palë të bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Kundër pikës II të aktgjykimit, në afatin ligjor ankesë ka paraqitur paditësja, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo i plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i atakuar të prishet dhe lënda të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim apo të ndryshon aktgjykimin.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor ankesë ka paraqitur e paditura, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo i plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i atakuar të prishet dhe lënda të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim.

Përgjigje në ankesë nuk kanë paraqitur palët ndërgjyqësve.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195, 200 e lidhur me nenin 505.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesat e ndërgjyqësve janë të pa themelta.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja NH "NN" sh.a. me seli në Gjakovë, pran Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me datën 03/07/2015, ka paraqitur padi kundër të paditurës NN sh.a (ish-Gorenje NN) sh.a me seli në Gjakovë, për pagimin e borxhit, me kërkesë që të detyrohet e paditura që në emër të borxhit, t'ia paguaj paditëses shumën e përgjithshme prej 23,000.00 euro si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestimore. Sipas referatit të padis rezulton se ndërgjyqësit kanë qenë në raporte detyrimore sipas aneks kontratës 02/372 e datës 20/06/2014, në të cilin raport juridik paditësja ka qenë në cilësinë e huadhënësit, ndërsa e paditura në cilësinë e huamarrësit dhe me këtë aneks kontratë palët më gjerësisht i kanë rregulluar të drejtat dhe detyrimet e tyre si vijon: Paditësja ia ka dhënë në huazim të paditurës shumën e të hollave në lartësi prej 15,000 euro e cila kjo e fundit e ka pasur për obligim që këtë shumë të kthej deri me datën 30/06/2015, mandej sipas kontratës nr.02-27 e datës 16/08/2010, ndërgjyqësit kanë arritur marrëveshje tjetër që paditësja t'ia jap në huazim të paditurës edhe shumën tjetër të të hollave prej 8,000 euro, të cilën shumë e paditura ka qenë e obliguar të kthej deri me datën 16/08/2010. Paditësja këtë huadhënie të të hollave ia ka bërë të paditurës përmes gjiro llogarive bankare dhe atë si vijon: shumën prej 8000 euro e ka bërë me datën 16/08/2010 ndërsa shumen prej 15.000 euro e ka transferuar në dy pjesë dhe atë me datën 03/02/2003 dhe me datën 30/04/2003, dhe meqenëse e paditura deri me tani nuk e ka përmbushur obligimin e saj financiar, nga këto arsye ka kërkuar mbrojtje gjyqësore.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë, me datën 24/10/2016 ka mbajtur seancën gjyqësore në të cilën seancë janë administruar provat e propozuara dhe mbi bazën e tyre është vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të

atakuar, duke vërtetuar pjesërisht pretendimet që rezultojnë nga padia e paditëses dhe këtë vendim e bazon në nenin 15, 17.1, nenin 277, 562, 559 par.2 të LMD-së, ndërsa lidhur me vendimin mbi shpenzimet e procedurës, e ka marr konform nenit 463.2 dhe nenin 143 par.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, pas analizimit dhe shqyrtimit me kujdes të shtuar të provave që gjenden në shkresat e lëndës, në raport me pretendimet ankimore erdh në përfundim se ankesat e paditëses dhe të padituës janë të pabazuar, për arsye se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike se ndërgjyqësit me datën 15/08/2013 kanë lidhur aneks kontratën dhe sipas nenit 1 dhe 3 të kësaj kontrate, subjektet kontraktues kanë paraparë zgjatjen e afatit të kthimit të huas të vlerës prej 15.000 euro, e të cilën shumë e paditura e ka pasur për obligim të paguaj deri me datën 30/06/2015, ndërsa në nenin 2 të aneks kontratës, palët ndërgjyqëse kanë paraparë se kontrata për shitblerjen e aksioneve e datës 14/09/2009 dhe marrëveshjen për kthimin e huas me numër 02-112 e datës 14/09/2009 të konsiderohen të pa vlefshme, për shkak të vendimi i asamblesë së aksionarëve të Bankës Ekonomike për mos lejimin e bartjes se aksioneve në favor të paditëses. Andaj sipas nenit 17 të LMD-së ligjvënësi ka paraparë: *Pjesëmarrësit e marrëdhënies së detyrimit kanë për detyrë ta zbatojnë detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij,* ndërsa neni 262 i po këtij ligji ka paraparë: *Kreditori në raportin e obliguar është autorizuar që prej debitorit të kërkojë mbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta mbush me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij.*

Kolegji i Gjykatës së Apelit ka ardhur në përfundim se pretendimet ankimore të të padituës janë të pa bazuar dhe në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës, për arsye se aneks kontratën e datës 15/08/2013 e kanë nënshkruar ndërgjyqësit dhe njëkohësisht e ka protokolluar vetë e paditura dhe me asnjë provë të vetme juridike e paditura nuk ka arritur të vërteton se e ka paraqitur ndonjë kundërshtim apo ka iniciuar ndonjë procedurë gjyqësore lidhur me këtë punë juridike të ndërgjyqësve. Në këtë situatë juridike ligjvënësi në nenin 319.1 të LPK-së, ka paraparë si vijon: *Secila nga palët ndërgjyqësve ka për detyrë të provoje faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta,* ndërsa neni 322.3 i po

këtij ligji, gjithashtu ka paraparë: *Pala e cila e konteston ekzistimin e ndonjë të drejte e bartë barrën e të provuarit të faktit që e ka penguar krijimin apo realizimin e saj, ose në bazë të të cilit ka pushuar se ekzistuari, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër.* Në këtë rast e paditura me asnjë provë të vetme nuk ka arritur të argumenton të kundërtën e asaj që pretendon paditësja dhe atë të cilën e ka vërtetuar gjykata e shkalles së parë, e të cilat kontrata janë të firmosura dhe janë protokolluara nga e paditura.

Kolegji i Gjykatës së Apelit i vlerësoj edhe pretendimet ankimore të paditëses se kërkesa e saj juridike nuk është e parashkruar, por një pretendim i tillë nuk qëndron dhe është i pa bazuar, për shkak se gjykata e shkalles se parë, mbi bazën e provave të administruara në prezencën e palëve ndërgjyqëse, me të drejt ka vërtetuar se kërkesa e paditëses sa i përket shumes prej 8000 euro është e parashkruar, nga fakti se e drejta paditëses për të kërkuar pagimin e borxhit ka lindur me datën 16/08/2010, ndërsa padinë e ka ushtruar me datën 03/07/2015, që nënkupton se padia është ushtruar pas kalimit të afatit ligjor prej 3 viteve. Me këtë gjendje faktike të vërtetuar, gjykata e shkalles së parë drejt e ka zbatuar të drejtën materiale të paraparë me nenin 374 të LMD-së e cila norme juridike ka paraparë: *Kërkesat reciproke të personave shoqëror juridikë nga kontrata në qarkullimin e mallrave e të shërbimeve si dhe kërkesat e kompensimit për shpenzimet e bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tre vjet. Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo livrim malli, punë ose shërbim të kryer.*

Gjykata e Apelit nuk e murr për bazë provën e paraqitur me ankese dhe atë Aneks Kontratën e lidhur me datën 15/08/2013 në mes ndërgjyqësve dhe të protokolluar nga e paditura me numër 02/371 e datës 20/06/2014, me të cilën punë juridike palët kanë paraparë zgjatjen e kthimit të huas për shumën prej 8,000 euro dhe atë deri me datën 30/06/2015, por këtë provë juridike paditësja nuk e ka prezantuar gjatë seancës gjyqësore, ndërsa nga përmbajtja e provës rezulton se paditësja ka qenë në dijeni për ekzistimin e kësaj prove e gjithë ashtu edhe në mjetin e rregullt juridik, paditësja nuk ka paraqitur asnjë arsye se pse kjo provë nuk është paraqitur gjatë shqyrtimit gjyqësor. Sipas nenit 180 par 1 të LPK-së, ligjvënësi ka paraparë: *Në ankesë nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të propozohen prova të reja, përveç se kur ankuesi jep prova se pa fajin e vet nuk ka mundur t'i paraqesë, përkatësisht t'i propozojë gjer në përfundimin e shqyrtimit kryesor në gjykatën e shkallës së parë.* Në këto rrethana juridike, gjithmonë pala ka faj në kuptim të kësaj norme, nëse ajo me dashje nuk ka paraqitur një fakt. E njëjta situatë do të vlejë edhe atëherë, kur pala do të duhej të ishte në dijeni (pakujdesia e rëndë) se ekziston ndonjë fakt ose provë, që do të ndikonte në vendimin e gjykatës.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera ankimore, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike duke dhënë arsye të mjaftueshme, ndërsa pretendimet e paditëses dhe të padituës janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës. Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërthënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata e Apelit.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195 par.1 pika d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
-Departamenti për Çështje Ekonomike-
Ae.nr.10/17, me datën 27/05/2019

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari
Liridon Maloku, d.v